

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

UniOptikal Distributor

THEMELIMI

Bazuar ne kërkesat e ligjit 9901 datë:14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), vendosem të themelojme shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **UniOptikal Distributor** me ortaket themelues:

- **Z. Bledar Hoxha**, i identifikuar me kartë identiteti **I00411092Q** i datelindjes 11.04.1980;

sot me date: 24.01.2024 dhe te hartojme kete Akt-Themelimi te Shoqerise.

SELIA

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti: do të jetë ne territorin shqipëtar .

Selia e shoqërisë do të jetë ne: **Tirane,Rr.Dritan Hoxha, Pall. Hawaii, Nr.147/15, Njesia Nr.7.**

FORMA JURIDIKE

Në mbështetje të ligjit 9901 date 14.04.2008. “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“(i ndryshuar), forma e juridike e shoqërisë është: **Shoqeri me Përgjegjësi të Kufizuar.**

EMRI I SHOQERISE

UniOptikal Distributor

KOHEZGJATJA

Kohë zgjatja e veprimtari së ekonomike të shoqërisë është e pakufizuar në kohë.



OBJEKTIVI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE DO TE JETE

Objekti veprimtarisë ekonomike i shoqërisë me pergjegjesi të kufizuar **UniOptikal Distributor** është: Veprimtari ne sektorin e optikes. Tregtim me shumice te syzeve optike, syzeve te diellit dhe te gjithë aksesoreve te tyre. Tregtim i aparateve mjeksore te artikujve farmaceutike, kozmetike dhe import eksportin e tyre. Tregtim te suplementeve alimentare (te ushqimit).

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqërisë **UniOptikal Distributor** eshte në para, i derdhur, në vlerën totale 1,000,000 (Njemilion) leke: me pjesmarrje të ortakeve si me poshtë:

1. **Z. Bledar Hoxha**, 1 kuote = 1.000.000 leke e barabarte me 100% te kapitalit themeltar;

ORGANET DREJTUESE

Asambleja është organi më i larte vendimor i shoqërisë. Ortaket kane të drejtë të marrin pjesë në asamble dhe të bëjnë present opinionet e tyre.

Numri i votime vetë çdo ortaku është në raport me pjesën e tij në kapitalin themelor të shoqërisë.

Për nevojat e veta, Shoqëria ka të drejtë te punësojë punonjës të tjerë, me të cilët sipas ligjit "Mbi Mardheniet e Punës" dhe dispozita e Kodit te Punës duhet të lidhe kontratë pune , në të cilën të parashikojë kohën e punës, llojin e saj dhe detyrimet reciproke , etj .

Shoqëria **UniOptikal Distributor**, do të drejtohet nga administrator i Shoqërisë , **Z. Bledar Hoxha**, me një afat 5 vjeçar .

Në marrdhenie me te tretë, shoqëria përfaqësohet nga administratori.

Në emër të shoqërisë firmos administratori, i cili bashkëngjit emërtimin tregtar të shoqërisë, emrin e mbiemrin e vet dhe funksionin e tij .

Shoqëria do të ketë dhe vulën e saj .

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortaket themelues.

Ky Akt-Themelimi u themelua sot me datë : 24.01.2024

SHOQERIA
UniOptikal Distributor

ORTAKET
Bledar Hoxha

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke extending to the right.